



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE



URDHRI I INFERMJERIT
REPUBLIKES SE SHQIPERISE

MEMORANDUM MIREKUPTIMI

NDERMJET

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

DHE

URDHRIT TË INFERMJERIT NE REPUBLIKEN E SHQIPËRISË

E lidhur sot në datë 19.12.2008, me të cilën Ministria e Shëndetësisë dhe Urdhri i Infermjerit në Republikën e Shqipërisë, këtu e tutje të quajtura "Palë", me qëllim zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe reformës në shërbimin shëndetësor, për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të ushtrimit profesional dhe të cilësisë në kujdesin infermjeror, pranojnë domosdoshmërinë për bashkëpunim në partneritet dhe bien dakord që ta realizojnë këtë bashkëpunim, si më poshtë:

Neni 1

Urdhri i Infermjerit të Republikës së Shqipërisë e konsideron Ministrinë e Shëndetësisë si partnerin strategjik dhe shpreh angazhimin t'a mbështesë atë në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sistemit shëndetësor në Shqipërisë.

Neni 2

Në mbështetje dhe për zbatim të Ligjit nr. 9718, datë 29.04.2007 "Për Urdhrin e Infermjerit në Republikën e Shqipërisë", Ministria e Shëndetësisë angazhohet të mbështesë Urdhrin e Infermjerit, duke i siguruar ambiente dhe paisjet e nevojshme për fillimin e punës, në përmbushje të misionit të tij, si në qendër dhe në qarqe.

Gjithashtu, angazhohet të përfshijë Urdhrin e Infermjerëve, në hartimin dhe diskutimin e akteve ligjore, dokumentave dhe analizave të tjera të rëndësishme për kujdesin infermjeror.

Neni 3

Palët mbështesin parimin për implementimin e procesit të liçensimit dhe të ri-liçensimit profesional individual të infermjer – mami – fizioterapeftëve, si detyrim për ushtrimin e profesionit në sistemin publik dhe privat të shërbimeve mjekësore duke mos punësuar asnjë infermjer – mami – fizioterapeft, pa qenë anëtar i Urdhrit të Infermjerit.

Neni 4

Ministria e Shëndetësisë dhe Urdhri i Infermjerëve në bashkëpunim dhe mirëkuptim të ndërsjelltë angazhohen të ndjekin masat organizative për futjen dhe përsheptimin e aplikimit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional Mjekësor të infermjerë – mami – fizioterapeftëve, duke përfshirë në këtë proces shoqatat profesionale - shkencore të kësaj kategorie, stafin akademik të Fakulteteve të Infermjerisë si dhe aktorë të tjerë.

Neni 5

Duke konsideruar ndjenjën e përgjegjësisë dhe integritetit profesional si mundësinë e vetme drejt arritjes së një profesionalizmi të ri, më afër standardeve Evropiane, Ministria e Shëndetësisë, bazuar mbi parimin e decentralizimit dhe delegimit të kompetencave, si dhe përvojën e vendeve të tjera në rajon, do të njohë dhe të mbështesë Urdhrin e Infermjerit për drejtimin e procesit të vetregullimit profesional në kujdesin infermjeror, si praktikë e përvojë e njohur dhe e implementuar prej vitesh në këto vende.

Neni 6

Në respekt e në zbatim të neni 5, të Ligjit nr. 9718, datë 29.04.2007 "Për Urdhrin e Infermjerit në Republikën e Shqipërisë", Ministria e Shëndetësisë do të ushtrojë kompetencat e saj ndaj institucioneve të vartësi, për të mos lejuar punësimin e infermjer – mami – fizioterapeftëve, pa qenë të pajisur paraprakisht me dokumentin e anëtarësimit në Urdhrin e Infermjerëve.

Neni 7

Duke patur parasysh krizën e besimit në rritje ndaj ofrimit të shërbimeve shëndetësore, me qëllim rritjen e mëtejshme të standarteve në kujdesin infermjeror si dhe mbrojtjen e pacientit nga kequshtrimi i profesionit, palët në bashkëpunim do të organizojnë ushtrimin e kontrolleve mbi standardet e ushtrimit profesional, problemet e sjelljes etiko-morale dhe

korrupsionin në kujdesin infermjeror, si në sistemin shëndetësor publike edhe atë privat, duke zbatuar me korrektësi Kodin Etiko - Deontologjik të Urdhrit të Infermjerit.

Neni 8

Mbështetur në nenin 8, të ligjit, si dhe në vet vullnetin e anëtarëve të Urdhrit të Infermjerit, Ministria e Shëndetësisë angazhohet, që nëpërmjet institucioneve të saj të varësisë, të mbështesë Urdhrin e Infermjerit, për grumbullimin e kuotës së anëtarësisë dhe derdhjen e saj në Llogarinë Bankare të Urdhrit të Infermjerit, nr. 145351, Banka Credins.

Neni 9

Palët marrin angazhimin e përbashkët për të transmetuar frymën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit që mbart nënshkrimi i këtij Memorandumi, në të gjitha strukturat e tyre qendrore dhe lokale.

PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË

MINISTRI

ANILA GODO



PËR URDHRIN E INFERMJERIT

PRESIDENTI

SABRI SKENDËRI

